



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 60, dt. 11.03.2016

Në mbështetje të nenit 27 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, si dhe VKM nr.619, dt.07.07.2015, ” Për shpalljen “Qendër Historike” të një zone në qytetin e Gjirokastrës dhe miratimin e rregullores “Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur në qytetin e Gjirokastrës”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.03.2016, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit për shpalljen monumente kulture të kategorisë së II-të, të disa objekteve në Qendrën Historike dhe Zonën e Mbrojtur të Gjirokastrës, sipas listës dhe hartës bashkëlidhur.
 2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI